

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Pro Vizion 3" SHPK**

Sot më datë 09/05/2022 une e quajturi Ilir Laska ,atesia Ndue lindur me Dt.14/02/1985,aktualishte banues ne Mamurras Kurbin i identifikuar me karte identiteti: I50214127D ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.R, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I
EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë është "Pro Vizion 3" Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adrese: Ruga:A Z Cajupi , njesi sherbimi nr Prone 6237 zona kadastrale 8380 Njesia Bashkjake Nr 10 Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adrese tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne:

- Aktivitet import-eksport, sherbime kompjuterike ,krijim faqe online ,konsulenca dhe shtitje produkte online .etj ,ndermjetesim ne fushen e import-eksportit, shitje, blerje, sherbime konsulence ne fushen e import-eksporteve.

aktivitet ne fushen e rregjimit te perpunimit aktiv, ndermjetesim, nenkontraktim me te trete per cdo hap te domosdoshem ne fushen e rregjimit te perpunimit aktiv si dhe cdo veprim tjetër te parashikueshem nga ligji persa i perket objektit te mesiperm.

- Prodhim çantash portafola rrypa

4.2 Për te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqëria mund te veproje ne Shqipëri dhe jashtë, dhe te kryeje çdo aktivitet tjetër te nevojshëm, te lidhur, instrumental, te përafërt, elementar, ose sidoqoftë te dobishëm, për shembull:

Te ofroje garanci reale dhe/ose personale si për detyrime te vetat, ashtu edhe për te tretët. Te marre përsipër, te lejoje dhe lose te heqë dore nga pjesëmarrje direkte ose indirekte ne shoqëri te tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe te huaja, qe kryejnë veprimtarinë e tyre ana tyre, me qellim qe te lehtësojnë realizimin e objektit social; Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport te mirash, shërbimesh dhe produktesh;

Ne kuadër te ligjit, te krijoje veprimtari dhe filiale te përfaqësimit.

NENIS KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabarte me 100.000 Leke (njqindmije Leke), i shlyer plotësisht, me para, nga ortaku Ilir Laska.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga I kuota, te ndara si me poshte vijon:
- ***1 kuote qe perben 100% te kapitalit, me vlere te pergjithshme 100.000 Leke, e shlyer nga ortaku Ilir Laska.***
- 7.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaket themelues.
- 5.2 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjerë. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqëri, duhet t'ia ofroje ketë kuote për blerje ortakeve te Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) diteve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do te kenë te drejtën te blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës për te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaket do te kenë te drejtën e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne



përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zotëron secili ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i te drejtave përkatëse ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vlerën e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.
- 6.2 Personi qe fiton te drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjetër te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar te drejtën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotes.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe janë thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejtën te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zotërojnë ne Shoqëri.



- 7.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit te pjesës se tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund te nënshkruhet nga ortaket e tjerë. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë serish te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zvogëloje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim .
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (konference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe



shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të behet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.

- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakeve, vendimet duhet të përshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqëritë tregtare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të të paktën 51 % të ortakeve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) në bazë të nenit 87 pika I, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqëritë tregtare", për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhë prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:



Iir Laska

- 10.2 Administratori/t zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e te cilëve i rezervohet Asamblesë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë dhe mund te autorizojë persona te trete, për te përmbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë.
- 10.4 Administratoret nuk do te mund te marrin hua nga Shoqëria ose te lëshojnë garanci, dorëzani, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë, për hua dhe financime te dhëna nga te tretet.
- 10.5 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe vetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftojë menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 11 VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

NENI 12 KONTROLI FINANCIAR

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emërojë një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne baze te ligjit.

NENI 13 BILANCI VJETOR

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .



- 13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 14
DIVIDENDET

- 14.1 Ne përputhje me dispozitat ligjore. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

NENI 15
ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

- 15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 16
GJUHA


- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

NENI 17
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

- 17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me ketë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne ketë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAK I SHOQERISE

Illir Laska

Illir Laska


Cel: 0634801811

email: ilirlaska.1234@gmail.com